



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 4 korrik 2013
Nr.ref.:RK436/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI45/13

Parashtrues

Znj. Jasmine Baxhaku

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme, Ac. nr. 65/2012, të 29 tetorit 2012**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga znj. Jasmine Baxhaku nga Dragashi, me vendbanim në Prishtinë (parashtruesja).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Ac. nr. 65/2012, të 29 tetorit 2012, të cilin parashtruesja e ka pranuar më 19 nëntor 2012.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ac. nr. 65/2012 të 29 tetorit 2012, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtrueses të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta); neni 47 dhe 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji); dhe në rregullin 28 dhe 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 19 mars 2013, parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese.
6. Më 25 mars 2013, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesja e kërkesës që ta kompletonte kërkesën e saj.
7. Më 16 prill 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin: Almiro Rodrigues, si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
8. Më 8 maj 2013, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës dhe e informoi Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 17 qershor 2013, Kryetari zëvendësoi gjyqtaren Arta Rama-Hajrizi, si anëtare të Kolegjit shqyrtues, me Prof. dr. Enver Hasanin.
10. Më 19 qershor 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 8 maj 2012, bashkëshorti i parashtrueses paraqiti padi në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë kundër parashtrueses për zgjidhjen e martesës, të lidhur më 7 korrik 2010.

12. Më 12 korrik 2012, parashtruesja iu përgjigj padisë, duke e kontestuar kërkesën e paditësit për zgjidhjen e martesës, për faktin se ata asnjëherë nuk kishin diskutuar për shpërbërjen e saj.
13. Më 15 maj 2012, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktvendimi, C. nr. 1003/2012) sipas kërkesës së parashtrueses (pala e mbrojtur) lëshoi një “urdhër për mbrojtje” duke e ndaluar bashkëshortin të ushtrojë çfarëdo lloj kërcënimi ose dhune familjare kundër parashtrueses dhe e urdhëroi atë që ta lejojë parashtruesen t’i marrë gjërat e saj personale në shtëpi.
14. Më 27 korrik 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi, C. nr. 125/12) mori vendim për “zgjidhjen me shkurorëzim” të martesës ndërmjet ndërgjyqësve dhe e detyroi parashtruesen t’i kompensojë shpenzimet e procedurës. Gjykata e arsyeton vendimin e saj si më poshtë:

“Prandaj, Gjykata konsideron që një martesë mund të ekzistojë vetëm në rastet kur në mes të bashkëshortëve ekziston dashuria, respekti reciprok, jeta e përbashkët dhe dëshira që të jetohet në bashkësi martesore, mirëpo, në rastin konkret këto elemente nuk qëndrojnë, e kjo arsyeton që martesë në fjalë duhet të zgjidhet, ngase nuk është në interes as të bashkëshortëve, e as të shoqërisë që martesë të ekzistojë vetëm në librat e organeve kompetente derisa e njëjta në realitet nuk ekziston. Gjykata nuk e pranoi propozimin e të autorizuarit të të paditurës që të dëgjohet në cilësi të palës edhe paditësi, kjo për arsye se paditësi është me punë në Austri dhe nuk është provuar me asnjë provë se ai është në Prizren, pasi që në pyetjen e Gjykatës se paditësi ka qenë në javën e fundit në Kosovë, e paditura është përgjigjur se nuk ka qenë dhe në të njëjtën kohë Gjykata konsideron se mjafton vetëm të dëgjohet njëra palë ndërgjyqëse. Vetë fakti se e paditura në mënyrë të qartë ka sqaruar raportet e çrregulluara martesore në aktvendimin e lartcekur të Gjykatës Komunale në Prishtinë, është e mjaftueshme për këtë gjykatë, për të përfunduar se raportet e bashkëshortëve janë çrregulluar seriozisht dhe kanë marrë karakter të përhershëm, dhe se qëllimi i vetëm i këtij propozimi është që të shtyhet, përkatësisht të prolongohet zgjidhja e kësaj martesë, e jo se nuk janë çrregulluar raportet në mes të palëve ndërgjyqëse”.

15. Më 22 gusht 2012, parashtruesja ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren.
16. Më 29 tetor 2012, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Ac. nr. 65/2012), e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren C. nr. 125/2012 të 27 korrikut 2012. Gjykata Supreme arsyetoi se gjykata e instancës së parë “në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka vlerësuar provat e administruara në kuptim të nenin 8 të LPK-së, nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Gjykata e shkallës së parë ka zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale neni 69 pika 1 dhe 2 të Ligjit mbi familjen, kur ka zgjidhur martesën e ndërgjyqësve, duke gjetur se martesë në mes ndërgjyqësve e ka humbur qëllimin e ekzistimit të saj. Martesë duhet të mbahet vetëm kur ekziston dashuria e ndërsjellë e bashkëshortëve, e cila shfaqet edhe me një bashkëjetesë

të harmonishme të tyre dhe nuk mjafton për ruajtjen e saj dëshira e njërës bashkëshort”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata e Qarkut në Prizren dhe Gjykata Supreme ia kanë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe me nenin 6 dhe 14 të KEDNJ-së.
18. Parashtruesja ankohet në Gjykatën Kushtetuese “për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.”
19. Parashtruesja kërkon nga Gjykata Kushtetuese që të detyrojë bashkëshortin të paguajë një dëmshpërblim në vlerë prej 15.000 eurosh, si pagim për gjërat e saj personale dhe të familjes së saj, të cilat nuk e kanë lejuar atë që t’i marrë ato, si dhe dëmshpërblimin për vitet e humbura, ndërprerjen e shkollës dhe traumave psikologjike, duke marrë parasysh që vetëm paditësi ka kërkuar shkurorëzimin dhe jo ajo.

Pranueshmëria e kërkesës

20. Gjykata vlerëson se nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret e parapara për pranueshmëri, të cilat janë të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (1) dhe (7) që përcakton se:
 1. *“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”*
[...]
 7. *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
22. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 48 të Ligjit i cili parasheh se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij/saj të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.
23. Për më tepër, rregulli 36 (1) c) dhe (2) a) dhe d) i Rregullores së punës parasheh që:
 - (1) *Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:*
[...]
 - c) *Kërkesa është qartazi e bazuar.*

(2) Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
 a) Kërkesa nuk arsyetohet *prima facie*;
 [...]
 d) Kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

24. Gjykata Kushtetuese vëren se parashtruesja e kërkesës nuk paraqet asnjë argument dhe provë si dhe pse Gjykata Supreme ia ka shkelur asaj të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë. Asnjë pretendim i ngritur mbi bazën e kushtetutshmërisë nuk është bërë nga parashtruesja, qoftë në mënyrë implicite qoftë në substancë, që do mbështeste shkeljen e pretenduar të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare.
25. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesja ushtroi ankesë mbi baza të shkeljes esenciale të dispozitave procedurale, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
26. Gjykata konsideron se këto pretendime janë të fushës së ligjshmërisë, të cilat bien nën juridiksion të gjykatave të rregullta.
27. Për më tepër, Gjykata rikujton se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të trajtojë gabimet e fakteve apo të ligjit (ligjshmërisë) që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta, përderisa ato nuk i shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
28. Ndërkohë, parashtruesja nuk ka shpjeguar pse dhe si i janë shkelur të drejtat e saj kushtetuese; ajo nuk e mbështet *prima facie* kërkesën e saj në baza kushtetuese dhe nuk ofron prova që tregojnë se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e saj, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të KEDNJ-së nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme. Në fakt, parashtruesja nuk e ka mbështetur dhe dëshmuar pretendimin në baza kushtetuese.
29. Kështu, Gjykata nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt, kur shqyrton vendimet e marra nga Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse si të së drejtës procedurale dhe atë të së drejtës materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
30. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese nuk mund të konsiderojë se procedurat përkatëse të Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
31. Prandaj, Gjykata gjen se, parashtruesja e kërkesës as nuk e ka ndërtuar, e as nuk ka dëshmuar një rast *prima facie*, qoftë mbi bazën e meritave apo pranueshmërisë së kërkesës.

32. Në tërësi, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtrueses, në pajtim me rregullin 36 (1) c) dhe 2) a) dhe d) të Rregullores së punës është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) c) dhe 36 (1) c) dhe 2) a) dhe d) të Rregullores së punës, më 4 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

